

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira – Departmant Slobodnih Profesija – Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Diciplinska Komisija/ The Disciplinary Comitee

Nr.08//2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUES PRIVAT, në përbërje të Xhemil Elshani kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha anëtarë, në çështjen disiplinore ndaj

organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i dyshuar për shkelje disiplinore të bëra në kundërshtim me nenet 24. par. 5, 36. par. 1, 37 dhe 38 par. 1 të LPP-së e lidhur me nenin 367 par.1 të LPP-së, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ MD.nr.09/2014, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë për profesionet e lira- Divizioni për Noteri dhe Përmbarimi privat Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore,

zyrës së çështjeve juridike, me prezencën e mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim të mbajtur me dt. 23.09.2020, muar këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET Raporti përfundimtarë i Ministrisë së Drejtësisë –Departamenti për profesione të lira – Divizioni për Noterin dhe Përmbaruesit Privati DPL 08/2020 të dt. 21.04.2020, dhe ankesa e dt. 19.03.2020, si e pa bazuar.

II.Organi Përmbarues- F i është përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduara në kundërshtim me nenet 24. par. 5, 36. par. 1, 37 dhe 38 par. 1 të LPP-së e lidhur me nenin 367 par.1 të LPP-së, sipas lëndëve përmbarimore P.nr. 272/20, 277/20, 279/20, 287/20, 291/20, 293/20 dhe 300/20.

A r s y e t i m

Pranë Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë, për fillimin e procedurës disiplinore ndaj r
si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për

territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkeljen disiplinore të bëra në kundërshtim me nenet 24. par. 5, 36. par. 1, 37 dhe 38 par. 1 të LPP-së e lidhur me nenin 367 par.1 të LPP-së, me dt.21.04.2020, bazuar në ankesën e ankuesit

ashtuar me dt. 19.03.2020, respektivisht me dt. 27.03.2020 e të plotësuar me dt. 21.04.2020, ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore sepse përmbaruesi privat në këtë rast me rastin e ndërmarrjes së veprimeve procedurale përmbarimore sipas lëndëve P.nr. 272/20, 277/20, 279/20, 287/20, 291/20, 293/20 dhe 300/20. ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit të procedurës përmbarimore, - neneve 24. par. 5, 36. par. 1, 37 dhe 38 par. 1 të LPP-së e lidhur me nenin 367 par.1 të LPP-së, me çrast ka tejkaluar autorizimet e tija bazuar në ligjin e përmbarimit, nuk i është përmbajtur ligjit të paraparë me nenet e lartpërmendura, dhe ka kërkuar nga komisioni disiplinor ti shqiptohet masa disiplinore e paraparë me ligjin mbi përmbarimin.

Ministria e Drejtësisë – Departamenti për profesionet e lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbaruesit Privat me dt. 21.04.2020 ja ka paraqitur komisionit disiplinor propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj r si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i dyshuar për shkelje disiplinore e nga nenet 367 par. 1 të LPP-së, sepse i njejtë me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore sipas lëndëve të përmbarimit P.nr. 272/20, 277/20, 279/20, 287/20, 291/20, 293/20 dhe 300/20, ka shkelur ligjin e përmbarimit si dhe ka tejkaluar autorizimet e tija ligjor.

Në kuptim të dispozitave të nenit 4 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MD.nr.09/2014 komisioni disiplinor ka caktuar seancën dëgjimore me dt. 23.09.2020 në ambientet- zyrat e Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën seancë kanë marrë pjesë të gjitha palët në procedurë,

si dhe përf. i Ministrisë së Drejtësisë- Departamenti për profesionet e lira – Divizioni për noteri dhe përmbarues privat Fadilete Hoxhaj në cilësinë e iniciuesit të procedurës disiplinore.

Përf. i autorizuari i Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për profesione të lira- Divizioni për noteri dhe përmbarues privat Fadilete Hoxhaj, në fillim të seancës dëgjimore ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj r nga Prishtina, duke theksuar se mbetet pranë pretendimeve të theksuara me shkrim të dt. 21.04.2020, se ka bërë shkelje disiplinore nga 367 par. 1 të LPP-së, sepse i njejtë me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore sipas lëndëve P.nr. 272/20, 277/20, 279/20, 287/20, 291/20, 293/20 dhe 300/20, ka bërë shkelje ligjore sepse ka tejkaluar autorizimet ligjore të tij.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me dt. 23.09.2020 kryesuesi i komisionit disiplinor në fillim të seancës dëgjimore ja ka dhënë mundësin shkelësit disiplinor të pretenduar respektivisht përmbaruesit privat që të deklarohej lidhur me përgjegjësinë disiplinore për pranimin e përgjegjësisë në pajtim me nenin 7 par. 3 të UA-MD. Nr. 09/2014 të procedurës disiplinore me çrast përmbaruesi privat ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduar.

I në përgjigjen e tij me shkrim të dt. 10.06.2020 ka deklaruar se pretendimet e ankuesit të thëna në ankesën e saj të dt. 19.03.2020 janë të pa bazuara, duke shtuar se e kundërshton në tërësi propozimin për fillimin e procedurës disiplinore e ushtruar nga ana e debitorit përkatësisht të pa bazuar, dhe mbetem në tërësi pranë deklaratës që kam dorëzuar tek Komisionit disiplinor të dt. 30.05.2020. Gjithashtu pretendimet e mia janë në deklaratë po shtoj se ekzekutimi i propozimit për përmbarrim përveç që është bazuar në LPK, gjithashtu është bazuar edhe në nenin 144 par. 1 nën par. 1 pika 3 të LPA-së e cila dispozitiv parasheh se kur është i ekzekutueshëm një akt administrativ i nxjerë në procedurë administrative. Po citoj njoftimi i palës me aktin kur sipas ligjit ankesa nuk ka efekt pezullues në këtë rast ankesat nuk kanë efekt pezullues por ka vetëm efekt devolutiv, kjo çështje është e rregulluar me ligjin e inspektoratit të punës përkatësisht me nenin 6 pika 4 e këtij ligjit, ku parasheh se ankesa kundër vendimit të nxjerë nga inspektorati i punës nuk e ndalon ekzekutimin. Ky është ligji i veçantë nuk qëndrojnë pretendimet e palës se kam ekzekutuar urdhër përmbarrimor pa vendos gjykata lidhur me prapësimin. Gjithashtu e kundërshtoj deklarinimin e palës debitorë ku thotë se përmbarruesi privat nuk është kompetent për të vendosur në këtë çështje, nuk qëndron kjo arsye se objekt përmbarrimi nuk ka qen vendimi gjyqësor por ka qen vendimi i nxjerë në procedurë administrative që ka të bëjë me detyrimin e nenit 23 par. 2 i LPP-së. Andaj bazuar në tërë këtë që thash më lartë i propozoj komisionit disiplinor që lidhur me ankesën e palës ankuese të vendos bazuar në ligj dhe prova.

Ankuesi

, gjatë seancës dëgjimore disiplinore ka theksuar se organi përmbarrues – me veprimet e tia përkitazi me përmbarrimin e çështjeve përmbarrimore sipas lëndëve P.nr. 272/20, 277/20, 279/20, 287/20, 291/20, 293/20 dhe 300/20 ka shkelur ligjin e procedurës së përmbarrimit dhe ka tejkaluar autorizimet e tia ligjore. Ashtu që në mënyrë të kundër-ligjshme ka lëshuar urdhrin për përmbarrim. Ka deklaruar se për këto çështje përmbarrimore nuk është kompetent përmbarruesi privat të zhvilloj procedurë përmbarrimore por kompetent është Gjykata Kompetente Themelore, për arsye se këtu kemi të bëjmë me vendime administrative që kanë të bëjnë me marrëdhënie të punës me të cilat vendime organi administrativ i ka nxjerë vendimet nuk e kanë patur klauzulën e plotfuqishmërisë. Për shkak të saj procedure debitorit i është shkaktuar edhe dëme material duke u ekzekutua këto lëndë nga ana e Thesarit ende pa përfunduar procedura përmbarrimore dhe procedura e ankimimit, ku përmbarruesi e ka dërguar propozimin për ekzekutimin e propozimit në Thesar. Andaj bazuar në këtë që thash më lartë kërkoj nga komisioni në fjalë që ndaj përmbarruesit privat të mirën masa disiplinore sipas ligjit.


Komisioni disiplinor pas përfundimit të seancës dëgjimore, të të gjitha palëve në procedurë, si dhe pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të njëjtave, veç e veç dhe të gjithave së bashku si dhe provave tjera të parashtruara me qëllim të vërtetimit të drejt dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje. Ka ardhur në përfundim se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe se me rastin e përmbarrimit të çështjes përmbarruese të lartpërmendur, nuk ka bërë shkelje disiplinore me rastin e zbatimit të LPP-së, si dhe as që ka bërë tejkalim të autorizimeve ligjore lidhur me çështjen në fjalë- çështjes përmbarrimore P.nr. 272/20, 277/20, 279/20, 287/20, 291/20, 293/20 dhe 300/20, nuk është gjetur se ka kryer shkelje disiplinore në këto çështje përmbarrimore për shkak se

gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbartimore i është përmbajtur dhe i ka zbatuar drejtë dispozitat e ligjit të procedurës përmbartimore.

Andaj më sa u tha më lartë e duke vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 4 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ- MD.nr. 09/2014, dhe nenit 374 par. 1 të LPP-së, komisioni disiplinor ka vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL. nr.08/2020 të dt. 23.09.2020

Kryetari i Komisionit Disiplinor
Xhemil Elshani



KËSHILLI JURIDIK : Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar sipas nenit 374 par. 5 të LPP-së